

KOMITETI DREJTUES

Nr. 65 Prot.

Tiranë, 12 Shtator 2025

Vendim Nr. 3 i KD-së

Komiteti Drejtues i FSHB-së në mbledhjen e sajë më datë 11 shtator 2025, drejtuar nga Presidenti, z. Avni Ponari, me prezencë të anëtarëve, znj. Migena Plasa, z. Dritan Mema, si dhe z. Klevis Kaso, duke formuar kuorumin e domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes, diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. **Fillimi i edicionit sportiv 2025–26** dhe diskutimi mbi organizimin e kampionateve kombëtare.
2. **Ekipi kombëtar meshkuj** – organizimi dhe ndeshjet e nëntorit 2025.
3. **Kërkesa për anëtarësim.**
4. **Të ndryshme.**

Komiteti Drejtues diskutoi sipas rendit të ditës, duke trajtuar problematikat për secilën pikë të tij.

Për sa më sipër, KD-ja vendosi:

1. Edicioni Sportiv 2025–26

1.1 – Kupa e Federatës për meshkuj dhe femra do të zhvillohet vetëm në rast se konfirmohet pjesëmarrja e të paktën katër ekipeve për secilën kategori.

1.2 – Shorti për fillimin e kampionateve kombëtare të meshkujve dhe femrave të rritur do të hidhet më 19 shtator 2025 (e premte), ora 10:00, në ambientet e FSHB-së, Tiranë.

1.3 – Superkupa për meshkuj dhe femra do të zhvillohet më 27 shtator 2025 (e shtunë), në Pallatin e Sportit “Feti Borova”, Tiranë, sipas programit:

- **Superkupa Femra** – Flamurtari vs. KS Tirana, ora 17:00
- **Superkupa Meshkuj** – Besëlidhja vs. Vllaznia, ora 20:00

1.4 – Superliga e Meshkujve do të nisë ndeshjet e javës së parë të kampionatit, më datat 3–4–5 tetor 2025, me 8 ekipet që janë renditur më mirë në edicionin 2025–26. Në të njëjtat data do të fillojnë edhe Kampionati Kombëtar i Femrave dhe Kategoria e I-rë për meshkuj, me të gjitha ekipet që kanë konfirmuar pjesëmarrjen dhe kanë plotësuar

dokumentacionin dhe detyrimet financiare. Në edicionin 2026-27 dhe në vijim, Superliga Meshkuj do të organizohet me 8 ekipe, ndërsa Kategoria e I-rë meshkuj me minimalisht 5 ekipe. Në rast rast të kundërt, atëherë kampionati do organizohet me një kategori. Udhëzohet administrata të bëjë ndryshimet në formatin e kampionatit kombëtar meshkuj.

1.5 – Kampionatet kombëtare të moshave do të nisin gjatë muajve tetor–nëntor 2025, sipas rakordimit të administratës, e cila do të njoftojë shoqatat e interesuara për secilën kategori.

2. Ekipi Kombëtar Meshkuj

2.1 – Administrata udhëzohet të nisë përgatitjet për organizimin e ekipit kombëtar të meshkujve, sipas kalendarit të ndeshjeve të Para-Eliminatoreve për FIBA EuroBasket 2029, si më poshtë:

- 27 Nëntor 2025 – Sllovaki vs. Shqipëri
- 30 Nëntor 2025 – Shqipëri vs. Kosovë
- 2 Mars 2026 – Shqipëri vs. Sllovaki
- 2 Korrik 2026 – Kosovë vs. Shqipëri

2.2 – Organizimi i ndeshjeve në të cilat Shqipëria është pritëse do të synohet në Pallatin e Sportit “Feti Borova”, Tiranë, nëse përfundon rregullimi i pajisjeve elektronike sipas udhëzimeve të FIBA-s. Në rast të kundërt, do të shqyrtohen opsione të tjera organizimi.

3. Kërkesa për anëtarësim

3.1 – Komiteti Drejtues miraton në parim kandidaturat për anëtarësim të shoqatave që kanë depozituar kërkesat pranë FSHB-së, si më poshtë:

Emërtimi i Shoqatës	Adresa	Vendimi i gjykatës
Qendra "Klubi Sportiv Tirana"	Tiranë	Nr. 1975, datë 06.02.2025
Shoqata "Akademia e Basketbollit TEB"	Tiranë	Nr. 7565, datë 21.05.2025
NRTHN Basket Crew	Shkodër	Nr. 7558, datë 02.05.2025
Qendra Minibasket Edisa	Tiranë	Nr. 7129, datë 07.06.2023

3.2 – Shoqatat e mësipërme do të pasqyrohen për miratim në Asamblenë më të afërt, për fitimin e anëtarësisë, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin sipas kërkesave ligjore dhe Statutit të FSHB-së.

3.3 – Klubi Sportiv Elbasani duhet të përshtasë formën e organizimit si organizatë sportive OJF sipas kërkesave të Ligjit të Sportit dhe Statutit të FSHB-së, përpara fillimit të edicionit sportiv 2026–27. Lojtarët/e që kanë pasur ose kanë kontrata me këtë klub do të regjistrohen dhe përfaqësohen nga ky ekip.

3.4 – Në Asamblenë më të afërt do të trajtohet mënyra e përfaqësimit të organizatave sportive OJF, përfaqësuese të klubeve sportive, duke siguruar të dhënat bazë të përfaqësimit në marrëdhëniet me FSHB-në. Këtu përfshihen personat përgjegjës për marrjen e vendimeve lidhur me ekipet e basketbollit, si dhe adresat dhe kontaktet përkatëse.

4. Të ndryshme

4.1 – Neni 6.3 i Rregullores Kombëtare të Aktiviteteve të Basketbollit do të përditësohet në përputhje me Kodin Civil dhe Kodin e Punës. Në këtë kuadër, do të lejohet nënshkrimi i kontratave ndërmjet shoqatave/klubeve dhe lojtarëve, trajnerëve apo stafit pa pasur domosdoshmërisht prezencën e noterit. Formulimi do të jetë si më poshtë:

“Kontrata konsiderohet e vlefshme vetëm në rastet kur ajo bëhet sipas kërkesave ligjore dhe Statutit të FSHB-së. Në rastet kur është e nënshkruar nga një agjent i licencuar nga FIBA dhe është firmosur para se lojtari/ja të mbërrijë në Shqipëri, në mënyrë elektronike, ajo pranohet e përkthyer nga një përkthyes zyrtar.”

4.2 – Komiteti Drejtues vendosi faljen e të gjitha pezullimeve të lojtarëve, trajnerëve dhe drejtuesve të vendosura në edicionin e kaluar 2024–25.

4.3 – U vendos heqja e sanksionit financiar ndaj ekipit Besëlidhja të datës 11.04.2025, lidhur me mungesën e forcave të sigurisë.

4.4 – U vendos zëvendësimi i z. Klaudio Ndoja, anëtar i Komisionit të Disiplinës, me z. Marsel Aliaj.